

KAPITULLI 80

KALLAJI DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Shënim

1 Në këtë Kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë bashkangjitur tyre:

(a) Shufra dhe shkopi:

Produkte të petëzuara, të stampuara, të tërhequra apo të farkëtuara, jo në spirale, të cilat kanë një seksion kryq uniform solid gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndëshit baras brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks (përfshirë "rrathët e dystuar" dhe "drejtkëndëshat e modifikuar", prej të cilëve dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tillë të cilët kanë një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar") i kalon një të dhjetat e gjerësisë. Shprehja gjithashtu përfshin edhe produktet e derdhura apo të shkrija, të formave dhe dimensioneve të njëjta, të cilët janë punuar vazhdimisht pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbukurimi apo heqja e bigorit), me kusht që si rrjedhim ato nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(b) Profile:

Produkte të petëzuara, të stampuara, të tërhequra, të farkëtuara apo të formuara, në spirale ose jo, të një seksioni kryq uniform gjatë gjithë gjatësisë së tyre, të cilët nuk përputhen me ndonjë nga përcaktimet e shufrave, shkopi, telave, fletave, shiritave, krisafeve, tubave apo tubacioneve. Shprehja gjithashtu përfshin edhe produktet e derdhura apo të shkrija, të formave të njëjta, të cilët vazhdimisht i janë nënshtruar punimeve pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbukurim apo heqje të bigorit), me kusht që si rrjedhim ato nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(c) Tela:

Produkte të petëzuara, të stampuara apo të tërhequra, në spirale, të cilat kanë një seksion kryq uniform solid gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndëshit baras brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks (përfshirë "rrathët e dystuar" dhe "drejtkëndëshat e modifikuar", prej të cilëve dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tillë të cilët kanë një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar") i kalon një të dhjetat e gjerësisë.

(d) Pllaka, fleta, shirita dhe krisafe:

Produkte me sipërfaqe të sheshtë (përveçse produkteve të papërpunuara të kreut 8001), në spirale ose jo, të një seksioni kryq drejtkëndësh (përfshirë edhe katrorin) me ose pa qoshe të rrumbullakosura (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar" prej të cilit dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele) të një trashësie uniforme, të cilat janë:

- në formë drejtkëndëshe (përfshirë katrorin) me një trashësi jo më tepër sesa një të dhjetat e gjerësisë,
- të një forme ndryshe nga drejtkëndësh apo katror, të çdo përmase, me kusht që ato si rrjedhim nuk marrin karakterin e produkteve apo të artikujve të krerëve të tjerë.

(e) Tuba dhe tubacione:

Produkte të zgavruara, në spirale ose jo, të cilët kanë një seksion kryq uniform vetëm me një zgavër bashkangjitur tyre gjatë gjithë gjatësisë në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndësh baras brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks, dhe të cilët kanë një trashësi uniforme të mureve. Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë edhe katrorin), trekëndëshit baras brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks, të cilët mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre, gjithashtu do të konsiderohen si tuba dhe tubacione me kusht që seksioni i brendshëm dhe i jashtëm të jenë baras qendrore dhe të kenë të njëjtën formë dhe orientim. Tubat dhe tubacionet e seksioneve kryq të sipërpërmendura mund të jenë të ilustruara, të veshura, të përkulura, të filetuara, të shpuara, të ngushtuara, të zgjeruara, të dhëna në formë koni apo të përshtatura me flanxha, bokulla apo unaza.

Shënim për nën krerët

1. Në këtë Kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë bashkangjitur tyre:

(a) Kallaj, jo i lidhur

Metal që përmban ndaj peshës te paktën 99 % kallaj, me kusht që përmbajtja ndaj peshës të bismuthit apo të bakrit është më e vogël sesa limiti i specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Elementet e tjerë

Element		Përmbajtja limit në % ndaj peshës
Bi	Bismuth	0,1
Cu	Bakër	0,4

(b) Lidhje kallaji

Substanca metalike në të cilën kallaji predominon në peshë mbi çdo elementet e tjerë, me kusht që :

(1) përmbajtja totale ndaj peshës e elementeve të tillë e tejkalon 1 %:

apo

(2) përmbajtja ndaj peshës ose e bismuthit ose e bakrit të jetë e barabartë apo më e madhe sesa limiti i specifikuar në tabelën e dhënë me lartë.

Kodi i mallrave	Përshkrimi	Njësitë plotësuese	Masa të politikës tregtare		Norma të detyrimit (%)	Norma preferenciale të detyrimit (%)	TVSH (%)	Norma të akcizës
			Importi	Eksporti				
8001	Kallaj i papërpunuar:					CEFTA / MSA / TR		
8001 1000 00	- Kallaj, jo i lidhur	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
8001 2000 00	- Lidhje kallaji	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
8002 0000 00	Mbetje dhe kthime kallaji	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
8003 0000 00	Shufra, shkopinj, profile dhe tela kallaji	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 7	18	-
[8004]								
[8005]								
[8006]								
8007 00	Artikuj të tjerë prej kallaji :							
8007 0010 00	- Pllaka, fleta dhe shirita , të një trashësie më tepër sesa 0.2 mm	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
8007 0080 00	- Të tjera	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 7	18	-